

Nr. Prot
Lutemi referoni këtë numër në përgjigje

Tiranë, më _____.____. 2022

Lënda : Kthim përgjigje

Në përgjigje të kërkesës tuaj dt 27.09.2022 ardhur në postën elektronike :

Pyetja :

Administratori i KESH, Ergys Verdho në një dalje për Klan News më 18 shtator ka deklaruar: “

“Sot KESH-i ka kapacitetet prordhuese për të absorbuar prurjet dhe njëkohësisht për të dhënë detyrimin për shërbim publik 12.900 mëh në ditë, pra nuk ka nevojë për import aktualisht dhe javës tjetër nuk do të ketë nevojë për import. Flasin për një histori e cila manaxhohet shumë mirë nga KESH. “

Ndërkohë, në faqen zyrtare të KESH, janë publikuar rezultatet e procedurave të blerjes së energjisë për periudhën 12-18 shtator si dhe për javën pasuese 21-25 shtator.

Çfarë e ndryshoi situatën, përse dolëm në import?

Përgjigje sqaruese nga KESH sh.a. dt.27.10.2022:

Kerkesa për informacion është nisur në dt. 27 shtator dhe në dt. 28 është publikuar lajmi në portalin tuaj pa pritur një përgjigje zyrtare nga KESH sh.a, link: [Shqipëria nuk i ndaloj importet e energjisë në javët e para të shtatorit - Faktoje.al](#)

Fjalja e shkëputur nga një dalje në studio e Administratorit të KESH që shtrohet si e pavërtetë ka nevojë për sqarim dhe e shkëputur nga konteksti i përgjithshëm i bisedës në studio, lë vend për keqkuptim. Ditë përpara artikullit të publikuar nga ju në dt. 28 shtator si dhe pas, ka pasur disa dalje të tjera të zotit Verdho në media të ndryshme ku sqarohet dhe pyetja juaj për importet e KESH në 2 javët e Shtatorit. Link: [SCAN UPDATE - Verdho: Anijet lundruese janë 'armët me të cilat do të luftojë KESH' - YouTube](#) (Min: 06:00-12:00)

[Kriza energjitike, Verdho: Aktualisht blejmë 30% të kapaciteteve tona | Breaking Top News - YouTube](#)

[Energjia nga anijet lundruese, Verdho: Ekspozimi ndaj çmimeve të importit jashtëzakonisht i ulët - YouTube](#)

Deklarata se : “Sot KESH-i ka kapacitetet prordhuese për të absorbuar prurjet dhe njëkohësisht për të dhënë detyrimin për shërbim publik 12.900 mwh në ditë, pra nuk ka nevojë për import aktualisht dhe javës tjetër nuk do të ketë nevojë për import. Flasim për një histori e cila manaxhohet shumë mirë nga KESH.”

Menaxhimi i kaskadës sidomos prodhimit dhe importit ka një dinamikë të vecantë, e cila përcaktohet nga vetë struktura e daljes në tregje për import dhe cmimi i burses. KESH i ka dhe sot kapacitetet për të absorbuar prurjet si dhe për të përmbushur detyrimin për shërbim publik, por nevoja për import vjen si pasojë e menaxhimit të rezervës energjitike në kaskadë.

Faleminderit!